



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



„Kualiteti“ SH.P.K.
Pronar - Shkelzen DESHISHKU
OSHP FAN TV
Rr/ Kosova 1, pn
Prishtinë

Ref:1510/1303/LIC/ni

Vendim

për ndërprerjen e licencës së transmetimit të OSHP FAN TV, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. FAN TV është Ofrues i Shërbimeve Programore, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e TV programeve përmes sistemit të Operatorëve Kabllorë , me seli në Prishtinë. KPM, me datën 6 tetor 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës për FAN TV.
3. Më datën 15 shtator 2015, pronari i OSHP FAN TV, përmesë një e-maili ka njoftuar KPM-në, se nuk është duke transmetuar program për një kohë të gjatë dhe se hjek dorë nga licenca e transmetimit e FAN TV.

Arsyetimi

4. Komisioni konstaton se, OSHP FAN TV ka vepruar në kundërshtim të plotë me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke ndërprerë transmetimin e programit dhe për këtë nuk e ka njoftuar fare KPM-në, ashtu siq përckatohet me Nenin 4, Paragrfin 2.1.(h). të këtyre kushteve:

1/2

“I licencuari duhet, që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, të informojë KPM-në për ndryshimet në të dhënat e mëposhtme, dhe të gjitha këto do të trajtohen nga KPM-ja si çështje të dhënash publike:

“Ndërprerje të transmetimit më të mëdha se programi i planifikuar i një dite të plotë.”


5. Komisioni konstaton se, OSHP FAN TV ka vepruar në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, me Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë (KPM-2014/03), si dhe me Ligjin e KPM-së për faktin se nuk i ka shlyer obligimet ndaj tarifës vjetore të licencës për vitet 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015.
6. Duke marrë parasyshë njoftimin e pronarit të OSHP FAN TV, për heqje dorë nga licenca si dhe veprimet tij në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë si dhe Ligjin e KPM-së, Komisioni konstaton se, ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së OSHP FAN TV.

Vendim

7. Komisioni në takimin e mbajtur më datën 8 dhjetor 2015, merr vendim për ndërprerjen e licencës së OSHP FAN TV, ndërsa, procedurat për shlyerjen e obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, mbetet të zbatohen në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Lëshimi i Vendimit

8. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



10.12.2015
datë